



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 35
Prishtinë, më 08.08. 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-II

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë, Rexhep Selimi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami dhe Nuredin Ibishi, Zafir Berisha anëtarë.

Mungoi: Qerim Bajrami.

Përfaqësuesit nga Policia e Kosovës- Shpend Maxhuni- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Riza Shillova- Drejtor i Departamentit të Hetimeve, Besart Mustafa-zyrtar ligjor.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Luanda Domi-DCAF, Sanije Berisha-OSBE, Blend Zyrapi-KIPRED, Isah Maloki-ICITAP, Naim Hajdari- EULEX, Shefki Kastrati-NDI, Agnesa Haxhiu-KDI, Eugen Cakolli-KDI

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit të mbajtur me datë 24.06.2016;

3. Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës z.Shpend Maxhuni rreth situatës së sigurisë në Kosovë;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Fillimisht falënderoi anëtarët dhe kryesuesin e Komisionit për kohën sa mbledhjen janë bojkotuar nga partitë opozitare, por që prania e sotme është për shkak të rrethanave të sigurisë dhe për të qenë prezent gjatë raportimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e komisionit të mbajtur me datë 24.06.2016.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës z.Shpend Maxhuni rreth situatës së sigurisë në Kosovë.

Kryesuesi- Theksoi se arsye e ftesës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës është për të informuar lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë, dhe fillimisht fjalën ia kaloi Drejtorit z.Shpend Maxhuni.

Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës- Sa i përket gjendjes së sigurisë theksoi që Policia e Kosovës vlerëson që është e qetë dhe stabile nën kontrollin e institucioneve të sigurisë. Për periudhën e parë të vitit 2016 theksoi që Policia e Kosovës ka realizuar të gjitha detyrat dhe planifikimet sipas planit strategjik njëvjeçar si dhe planit strategjik 2016-2020. Policia e Kosovës në vazhdimësi ka informuar opinionin publik, për sfidat dhe përgjegjësi dhe për çdo gjë tjetër që lidhet me interesin e përgjithshëm.

Më tutje theksoi që këtë periudhë kohore e karakterizojnë një sërë zhvillimesh në fusha të caktuara, por prioritet është qasja parandaluese e cila ka ndikuar në uljen e rasteve. Në bazë të planit Policia e Kosovës ka detyrat e caktuara, luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore, janë arrestuar një numër i caktuar i personave, janë identifikuar personat përgjegjës, gjithashtu edhe në fushën e luftimit me narkotik, Policia e Kosovës ka shënuar suksese konkrete. Viteve të fundit ka prezencë më të pakët të drogave të forta dhe ky është sinjal pozitiv në aspektin e sigurisë dhe kjo është si rezultat i forcimit të kapaciteteve në kuadër të policisë, pasi është avancuar edhe me strategjitë kombëtare, qasjen e bashkëpunimit rajonal duke ndikuar në situatën aktuale. Gjithashtu theksoi se ka prezencë të narkotikëve dhe është e llojit mariuanë dhe kanabis për shkak të mundësisë së kultivimit në fqinjësi por që edhe në vend ka pasur tendenca për të kultivuar këtë lloj të drogës.

Policia e Kosovës ka shënuar suksese edhe në luftën e luftimit të krimeve të përgjithshme, krimeve ekonomike, korrupsionit dhe fushave të tjera. Vazhdohet me masat konkrete shtesë për sigurinë e përgjithshme përmes së cilave është arritur parandalimi i veprimeve terroriste.

Kryesuesi- Fjalën ua kaloi anëtarëve të Komisionit.

Fadil Demaku- Shtroi pyetjen se çfarë mendon Policia e Kosovës për sulmin e ndodhur ndaj Kuvendit të Kosovës me datë 4 gusht? Ndërsa sa i përket qasjes parandaluese nga Policia e Kosovës, kërkoi të jepen më shumë sqarime lidhur me masat e ndërmarr nga Policia e Kosovës, duke ditur situatën politike në mes aketrëve politik që ka qenë më konfrontuese, dhe mundësia e shfrytëzimit të kësaj situatë nga element kriminal që mund të jenë armiq të shtetit tonë. Sa është e mundur që të informohet Komisioni, sa jemi të rrezikuar, sa janë masat e sigurisë?

Rexhep Selimi- Duke marrë shkas edhe situatën e sigurisë dhe rastin e ndodhur në sulmin ndaj Kuvendit të Kosovës, kërkoi që do të jepen informacione pa dëmtuar procesin e hetimit, që deri ku ka arritur Policia e Kosovës të kryej punë në drejtim të zbulimit të këtij rasti. Gjithashtu kërkoi sqarim edhe për rastin kur është shti me armë gjatë organizimit të “Beer Fest” ku si pasojë është anuluar ky aktiviteti tregtar, pasi në natën e parë ka ndodhur incidenti i armatosur dhe që për opinionin nuk është bërë e ditur për autorin dhe motivet e këtij akti, ndërkohë që në opinion ka krijuar panik dhe është dukur si një sulm terrorist. Prandaj vlerësoi që do të ishte mirë që Policia e Kosovës të ketë të dhënat për autorin dhe motivin e këtij veprimi. Bazuar në këto, a ka ndonjë lidhshmëri ngjarja e ndodhur në “Beer Fest” dhe sulmi ndaj Kuvendit të Kosovës?

Ganimete Musliu- Ngriti çështjen e trafikut dhe aksidentëve të shpeshta të cilat janë duke ndodhur, ku në çdo natë pasqyrohen të dhëna për rastet e humbjes së jetës në aksidente trafiku. Për këtë çështje shtroi pyetjet si në vijim. Çfarë ka bërë Policia e Kosovës, që numri i aksidentëve të zvogëlohet? A pritet që në të ardhmen të ketë ndonjë fushatë ndërgjegjësuëse lidhur me këtë çështje? Ndërsa duke iu referuar ngjarjeve, siç ishte ai i “Beer Fest” dhe sulmi ndaj Kuvendit, konsideroi se është vërejtur panik tek qytetarët. A duhet të jenë në panik qytetarët e Kosovës? A ka statistika për tre vitet e fundit, sa është bërë konfiskimi i armëve pa leje? Sa armë pa leje mund të jenë në duart e qytetarëve?

Nuredin Ibishi- Duke iu referuar deklaratës së përbashkët në seancën e mbajtur në Kuvend pas sulmit të Kuvendit, theksoi që fillimisht është dashur të posedohet informacion nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës për këtë çështje. Duke iu referuar edhe fjalës së z. Shpend Maxhuni, theksoi që kontrolli parandalues është aspekt i rëndësishëm dhe duhet të aplikohet. Gjithashtu kërkoi që nga ana e Drejtorit të jepen informacione, pa dëmtuar hetimet, për rastet e ndodhura, siç është “Beer Fest” dhe sulmi ndaj Kuvendit, si dhe masat të cilat duhet të merr Policia e Kosovës për parandalimin e situatave të tilla. Ndërsa sa i përket çështjes së trafikut, theksoi që në seancën e kaluar është miratuar Ligji për rregullat e trafikut rrugor.

Zafir Berisha- Në fillim të fjalës së tij, tha që edhe pse si subjekt politik janë në bojkot për shkak të marrëveshjeve të dëmshme të nënshkruara nga Qeveria, theksoi që do të kthehen në Kuvend kur trajtohen çështje të rëndësishme të veçantë dhe se për këtë qëllim janë prezentë, duke vlerësuar që siguria ka rënë në nivelin zero. Sa i përket sulmi ndaj Kuvendit, shtoi se informata

që dha drejtori, është e përgjithshme por në fjalën e tij nuk u përmend rasti i sulmit ndaj Kuvendit si dhe rasti i ndodhur gjatë “Bear Fest”. Më tutje konsideroi se pas ndodhjes së këtyre rasteve, duhet të ngritet niveli i përgjegjësisë tek hallka e rëndësishme e shoqërisë, siç është Policia e Kosovës dhe shtroi pyetjet si në vijim. A ndjeheni përgjegjës për dështimin e kapjes së aktorëve për sulmet e kryera ndaj institucioneve?

Gjithashtu vlerësoi se duhet të iket nga deklaratat por të merret seriozisht situata për të krijuar ambient të përshtatshëm për qytetarët.

Anton Quni- Fillimisht falënderoi për prezencën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, duke vlerësuar që do të ishte e mirë sikur sot do të prezantohej raporti për gjetjen e autorit që ka sulmuar ndërtesën e Kuvendit me datë 3 gusht. Ky rast ka tronditur opinionin por edhe më gjerë, duke krijuar pasqyrë të keqe për Kosovën. Më tutje shtoi që, vetëm sa për të bërë të qartë opinionin, që është thënë që mjeti me të cilin është goditur Kuvendi është një armë antitankë e quajtur Zola, është armë shumëfishë e fuqishme nga armët që posedojnë institucionet e sigurisë së Kosovës dhe kjo lenë të kuptohet që në Kosovë ka formacione që janë të përgatitura. Gjithashtu theksoi që fatmirësisht nuk është arritur dëm në njerëz.

Më tutje shtroi pyetjet si në vijim; nëse është mungesa e infrastrukturës ligjore që të veprohet nga Policia e Kosovës, kjo gjë duhet të adresohet në Komision. Por nëse kjo është mungesë e aftësisë së nivelit menaxheria, për këtë çështje duhet të jeni të sinqertë.

Nga takimi i mëhershëm në raportimet e zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është thënë që janë duke ndërtuar Polici të udhëhequr nga inteligjenca, prandaj një veprim i tillë është dashur të parandalohet. Nëse në këtë rast institucionet e Kosovës nuk veprojnë dhe të identifikojnë aktorët, kjo do të ishte inkurajim për formacionet kriminale, duke vlerësuar që situata politike është e ndjeshme dhe pistat e dyshimit janë të ndryshme, prandaj drejtori i Përgjithshëm i Policisë duhet të sjellë të vërtetën për këto ngjarje.

Bojan Mitiq- Përshëndeti të pranishmit duke shprehur mirëseardhjen e anëtarëve nga opozita. Më tutje shtroi pyetjen si në vijim. Sa mund të jenë të sigurt qytetarët dhe zyrtarë që janë punonjës në Kuvendin e Kosovës, pas sulmit që ka ndodhur?

Kryesuesi- Shprehi vlerësimin për situatën aktuale, duke konsideruar që sulmi ndaj Kuvendit është shqetësues dhe tendenca për të dhënë ngjyrimet politike është e dëmshme, pasi edhe opozita kundërshtimin si brenda Kuvendit ashtu edhe jashtë e ka bërë për të ruajtur Kosovën dhe se është Policia e Kosovës ajo që do të jap përgjigjeje.

Më tutje shtroi pyetjet si në vijim: në çfarë gjendje ka qenë zyrtari policor kur e ka vrarë Ilmi Lutën dhe a është përgjigjur dikush nga zinxhiri komandues? Me cilin vendim qeveritar bëhet kontrolli kufitar me Malin e Zi? A respektohet marrëveshja e votuar në Parlamentin e Malit të Zi apo i përmbaheni rregullave të vjetra? Pasi është bërë kontrolli deri te Kulla e Zhlepit tani nuk bëhet, është bërë kontrolli deri në Qakorr tani kanë zbritur poshtë. A janë urdhrat e njëjtë për të gjitha njësitë apo ka dallime në vendimmarrje? A kanë rrjedhur nga Policia e Kosovës përgjimet për rastin e quajtur “Afera Pronto II”? A ka mandat Policia e Kosovës të marrë këtë çështje si rast?

Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës- Në përgjigjeje të pyetjes së z.Fadil Demaku, theksoi që nga pozicioni që ka si Drejtor, nuk mund të komentoj dhe bëjë analiza politike, por që ka vend të kemi një qasje gjithëpërfshirëse, duke analizuar situatat dhe që

mund të ndikojnë në aspektin e sigurisë dhe konsideroi që është momenti i duhur të punohet në këtë drejtim. Ndërsa, sa i përket incidentit ku është sulmuar Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 4 gusht, konsideroi që ky është incident shumë serioz dhe në bashkëpunim me Prokurorin Speciale është cilësuar akt me element terrorist dhe do të trajtohet si i tillë. Më tutje shtoi, se dëshiron të siguroj të gjithë qytetarët e vendit që Policia e Kosovës me të gjitha kapacitete që ka në dispozicion do të veprojnë për të nxjerrë para drejtësisë akterët e këtij incidenti. Falënderoi qasjen e anëtarëve të Komisionit që mund të jetë i kufizuar në dhënien e informacionit, për shkak të ndjeshmërisë së rastit që është nën hetim. Ndërsa theksoi që për këtë incident, janë intervistuar disa persona dhe janë ndërmarrë një sërë masash konkrete për zbardhjen e këtij rasti, gjithashtu është ofruar shpërblim, ku është kërkuar nga qytetarët dhe kushdo që posedon informacione, për zbardhjen e këtij rasti. Në përgjigjeje të pyetjes së z.Rexhep Selimi, theksoi që Policia e Kosovës me të gjitha departamentet, njësitë organizative janë të kyçura njëzet e katër orë në organizimin dhe koordinimin për zbardhjen e këtij rasti, duke shtuar që do të dilet me rezultate për zbardhjen e këtij rasti.

Ndërsa sa i përket incidentit të ndodhur në “Bear Fest”, theksoi që qytetar të panjohur kanë shtënë me armë gazi në ajër dhe Policia e Kosovës ka marrë masat që situata të vihet nën kontroll. Po ashtu theksoi që për këtë ngjarje, nga Policia e Kosovës është planifikuar plani konkret me Kuvendin Komunal të Prishtinës dhe organizatorin.

Më tutje theksoi që janë dhënë disa vlerësime, se plani i tillë ka pas defekte nga parashikimet të cilat është dashur të planifikohen, nga organizatori i ngjarjes dhe si rrjedhojë ka pasuar vendimi që kjo ngjarje të shtyhet për datë tjetër. Nga struktura e Policisë së Kosovës është dërguar mesazhi i qartë që kurdo që diçka e tillë planifikohet të organizohet, duhet të jetë mirë e koordinuar me aktorët relevantë. Po ashtu shtoi se nuk ka vend për panik nga incidentet e ndodhura, duke apeluar qytetarët që të bashkëpunojnë ngushtë me Policinë e Kosovës.

Në përgjigjeje të pyetjes së znj.Ganimete Musliu, për sigurinë në trafik theksoi që kjo është temë dhe çështje me përgjegjësi dhe është injoruar nga shumë institucione, ndërsa Policia e Kosovës që nga themelimi i saj ka dhënë kontributin e saj, por që ka vend për përmirësime. Më tutje theksoi që Policia e Kosovës, ka planet e saj dhe në bazë të tyre operon dhe është pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë kur kërkohet kontributi në menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor, duke theksuar që do të duhet një qasje më ndryshe për të avancuar në aspektin e legjislacionit dhe pajisjeve që shfrytëzohen në menaxhimin e trafikut rrugor. Nga Policia e Kosovës janë dhënë të gjitha vërejtjet dhe kontributi përderisa është duke u përgatitur Ligji për rregullat e trafikut rrugor, pasi në Kosovë humbja e jetës së njerëzve ndodhë më së shumti në trafikun rrugor dhe kurdo që kërkohet adresimi i kësaj çështje si Drejtor i Policisë e bënë këtë gjë sa here jepet mundësia. Gjithashtu theksoi që gjendja jo e mirë e rrugëve, infrastruktura ligjore e mangët për politikat ndëshkimore ndikojnë në sigurinë e trafikut rrugor.

Ndërsa sa i përket numrit të armëve pa leje, theksoi që Policia e Kosovës në sekuestrimin e këtyre ka qenë e suksesshme dhe për vite të tëra janë sekuestruar dhe janë më mija armë që janë sekuestruar dhe është hartuar tashmë strategjia ku bëhet edhe shkatërrimi i tyre. Ndërsa sa i përket numrit të armëve pa leje në duart e qytetarëve, theksoi që është pyetje hipotetike dhe nuk do të jap përgjigjeje hipotetike, por që nga një raport vlerësues i UNDP-së i dhënë më parë, është supozuar që rreth katërqind mijë armë janë prezent në duart e qytetarëve dhe duhet të mendohet se çfarë mund të bëhet në këtë drejtim. Aktualisht është duke u punuar në përgatitjen e një amnistie, përmes së cilës qytetarët do të mund të dorëzonin vullnetarisht armët dhe kjo do të mund të ndihmonte që qytetarët të lirohen nga armët që mbajnë.

Gjithashtu theksoi që Policia e Kosovës në kuadër të Drejtorisë Kundër Krimit të Organizuar, ka sektorin e veçantë që përcjell fenomenin e armëve dhe është problem që përballët edhe rajoni. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet, që nuk ka tendenca të kontrabandimit me armë në territorin e Kosovës.

Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së z.Nuredin Ibishi, sa i përket masave të shtuara theksoi që masat janë të dukshme, por ka edhe masa të pa dukshme të cilat nuk duken dhe aplikohen sipas nevojës dhe në këtë kontekst, Policia e Kosovës me të gjitha kapacitetet që posedon, masat operative janë në dispozicion të ruajtje së rendit dhe të sigurisë publike dhe sigurisë së përgjithshme me tendencë për të avancuar në të dyja aspektet. Ndërsa sa i përket kontrollit parandalues, theksoi që kjo masë aplikohet kurdo herë që është e nevojshme dhe e kërkojnë rrethanat dhe është masë e paraparë nga Ligji. Ndërsa sa i përket pyetjes së z.Zafir Berisha, theksoi që janë përgjegjës dhe të përgjegjshëm për punën e Drejtorit të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës, dhe se kurdo herë që kërkohet të jap llogari, si në aspektin organizativ ashtu edhe në aspektin individual dhe nëse vërtetohet se si Drejtor i Policisë ka përgjegjësi dhe në asnjë rrethanë nuk i ikë përgjegjësisë.

Ndërsa sa i përket çështjeve të ngritura nga z.Anton Quni, theksoi që në aspektin e legjislacionit nuk është keq, janë disa që kërkojnë ndryshime, por që Policia e Kosovës është në lëvizje për të përshtatur me nevojat dhe rrethanat e kohës dhe këto nevoja adresohen tek institucionet kompetente. Ndërsa sa i përket, armës së përdorur ku është spekuluar se është përdorur arma e tipit Zollë, por që nuk bëhet fjalë për një armë të tillë, por për një armë tjetër. Fatkeqësisht në disa raste është gjetur armatim i rëndë dhe ky mesazh duhet kuptuar që Qeveria e Kosovës duhet të investon në avancimin e institucioneve të sigurisë, në realizimin e objektivave të saj, por duhet përcjell trendet globale. Ndërsa, pyetjes se a janë të sigurt bartësit e institucioneve, konsideroi që janë të sigurt dhe po ashtu edhe qytetarët e Kosovës, pasi të gjitha institucionet e rëndësishme sigurohen nga Policia e Kosovës me plane konkrete, duke theksuar që në Kosovë janë të pranishëm edhe disa mekanizma ndërkombëtar, që kanë përgjegjësi në aspektin e sigurisë dhe bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës, duke theksuar që duhet të jemi të kujdesshëm kur bëjmë prezantimin perceptimeve personale për sigurinë e vendit.

Më tutje theksoi që ka disa kërkesa, të cilat janë për qëllim të avancimit të sigurisë në vend, duke theksuar që kryeqyteti i Kosovës, Prishtina duhet të jetë i mbuluar me sistemin e vëzhgimit të kamerave si edhe qendrat e mëdha rajonale, duke kërkuar nga Komisioni që të përdor ndikimin e tij që kjo çështje të sensibilizohet në mekanizmat vendimmarrës. Ndërsa sa i përket çështjes së trafikut, konsideroi që është e domosdoshme që autostradat të mbulohen me kamera dhe radar të teknologjisë së lartë.

Kryesuesi- Duke iu referuar disa medieve jo miqësore ndaj Kosovës se në Kosovë mund të ketë kampe stërvitore nga ana e radikalëve fetar, ku edhe nga ana e *New York Times* është folur për këtë gjë. A qëndrojnë këto të dhëna dhe shkrime?

Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës- Në përgjigjeje të pyetjeve të z.Daut Haradinaj, theksoi që është bërë publik incidenti i ndodhur në Deçan, ku një zyrtar policor ka përdorur armën e zjarrit ku një qytetar i Republikës së Kosovës ka humbur jetën. Lidhur me këtë theksoi që hetimi është duke u zhvilluar në mënyrë të pavarur nga Inspektorati Policor dhe Prokuroria e Shtetit dhe informacionet fillestare janë dhënë duke u bazuar në raportin fillestar që ka disponuar Policia e Kosovës, dhe çdo gjë pas raportit fillestar, vazhdon të mbetet e Inspektoratit Policor dhe Prokurorisë së Shtetit. Ndërsa s i përket pyetjes se me cilin vendim

operon Policia e Kosovës në brezin kufitar me Malin e Zi, theksoi që funksionon me vendimin njëjtë siç vepron në gjithë territorin e Kosovës, dhe që nga fillimi Policia e Kosovës, patrullon në të njëjtën zonë dhe vijë. Ndërsa sa i përket çështje së përgjimeve të aferës “pronto” nuk kanë dal nga Policia e Kosovës, pasi hetimi për të cilin janë bërë përgjimet nuk është zhvilluar nga Policia e Kosovës. Ndërsa s ai përket tendencave për ta prezantuar Kosovën si vend me elemente radikale, theksoi që ka hapësirë për debat pasi ky problem mund të trajtohet në forma të ndryshme, por që me përgjegjësi deklaroi që në territorin e Kosovës nuk ka kampe të tilla që trajtojnë individ me prirje radikale, pasi Policia e Kosovës ka mekanizma për të kontrolluar gjithë territorin. Duk vlerësuar se duhet një mobilizim institucional dhe qytetar për këtë çështje.

Fadil Demaku- Për vizitën e realizuar nga ana e Komisionit, në stacionin policor në Veri të Mitrovicës, nga zëvendës komandanti i stacionit janë prezantuar vështirësitë në komunikimin për shkak të distancave të pikave ndërlidhëse për të proceduar raste e caktuar. Si është gjendja reale për këtë çështje?

Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës-Në përgjigjeje të pyetje së z.Demaku, theksoi që në disa raste pozicioni gjeografik mund të krijoj vështirësi, por në aspektin teknologjik është investuar dhe janë ngritur transmetues të veçantë, duke shtuar që pajisjet që përdoren dhe janë në dispozicion në gjithë territorin e Kosovës janë edhe në veri të vendit. Më tutje theksoi që nuk ka kërkesë specifike nga menaxhmenti i stacionit policor në veri të vendit, duke theksuar që problematike është menaxhimi i objekteve të cilat janë të trashëguara dhe jo në gjendje të mirë, duke theksuar stacionin policor në Zubin Potok, ndërsa në stacionet e tjera nuk ka kërkesë specifike.

Rexhep Selimi- Duke iu referuar edhe një here incidentit të ndodhur gjatë “Beer Fest, theksoi që nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm, u tha që ka pasur të shtëna me armë zjarri me gaz dhe kjo është kuptuar nga gëzhojat e mbetura në vendin e ngjarjes. Më tutje theksoi që i bëri përshtypje kur u tha që incidenti fillimisht ka qenë konflikt verbal mes dy personave. Përderisa dihet ky detaje, përse nuk dihet për identitetin e tyre? Duke vlerësuar që Policia e Kosovës, do duhej të bënte më shumë për identifikimin e këtyre personave, nëse ishte përgatitur për të ndodhur një panik i tillë apo jo? Më tutje theksoi që Policia e Kosovës, ka bërë gabim teknik, duke dhënë adresën e incidentit në një vend tjetër, duke mos iu referuar sheshit afër “Zahir Pajaziti”, ku kërkoi që të jenë më të kujdesshëm, duke mos lënë hapësirë për dyshim. Gjithashtu theksoi, që nga fjala e Drejtorit u duk që u ngarkua me përgjegjësi organizatori si edhe Komuna e Prishtinës, por shtoi se për aspektin sigurisë nuk është kompetencë e tyre, pasi nuk ka polici bashkiake për të ruajtur sigurinë.

Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës- Në përgjigjeje të pyetjes së z.Selimi, theksoi që fakti që mund të mos dihen emrat e atyre personave që kanë ushtruar konflikt verbal fillimisht është e mundur, pasi personi i tretë jo domosdoshmërisht mund ti ketë njohur me emër, duke shtuar që njësitë relevante janë të këqyra në hetim, duke theksuar që duhet lënë hapësirë deri në rezultatet përfundimtare dhe nuk ka pasur tendenca për krijimin e panikut në opinion.

Ganimete Musliu- Duke iu referuar vizitave që ka realizuar në veri të Mitrovicës,, theksoi që çfarë ka parë është makinat pa targa që lëvizin në qytet, duke konsideruar që përdoruesit e

makinave mund të jenë shkelës të ligjit potencial, arrë në konsideratë edhe brishtësinë e situatës atje. Cilat masa duhet të ndërmarra masa Policia e Kosovës për të ndaluar qarkullimin e makinave pa targa? A ndalohen personat që ngasin makinat e tilla?

Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës- Në përgjigjeje të pyetjes së znj.Musliu, theksoi që kjo çështje është trajtuar nga ana e Policisë, por duke shtuar që edhe për shkak vështirësive që kanë dal nga zbatim i marrëveshjes së Brukselit kjo çështje ka ngelur e tillë, por njësitë kompetente do të angazhohen për të ndërmarrë veprime konkrete. Makinat e tilla ndalen dhe kontrollohen nga Policia e Kosovës.

Nuredin Ibishi- Theksoi që ka bërë ankesën në Inspektoratin Policor për Togerin e Policisë z.Arben Visoqa, por deshi të njoftoj edhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, pasi lënda tashmë është tek Standardet Profesionale, duke theksuar që çdo zyrtar policor duhet të zbatoj kodin e etikës, duke kërkuar që mos të lejohet që personat e tillë të kenë fuqi.

Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës- Theksoi që menaxhmenti i Policisë së Kosovës me përkushtim trajton çdo ankesë të paraqitur, për këtë rast siguroi që pas hetimit që do të zhvillohet për këtë rast dhe për gjetjet që do të dalin dhe nëse dalin të dhëna që janë në kundërshtim me kodin e etikës, do të aplikohet dënimi i merituar. Duke theksuar që në Policinë e Kosovës, nuk ka individ mbi ligjin.

Zafir Berisha- Theksoi që edhe pse e kupton pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që ka prirje për të zvogëluar gjërat, por nuk pajtohet që situata e sigurisë është kaq e mirë sa paraqitet. Sa i përket kampeve stërvitore, theksoi që nuk është e vërtetë pasi ka pasur kampe të tilla dhe kjo është dhënë edhe në mediat vendore, ku ka pasur raportime se në anën e Debolldesë ka kampe të tilla. Nëse vlerësohet se kampe stërvitore vetëm me armë është gabim, pasi ka edhe të tillë pa armë, duke shtuar se si deputet ka përgjegjësi duke vlerësuar që situata është më ndryshe, duke kërkuar që mos të zvogëlohen gjërat.

Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës- Nga vlerësimet që ka Policia e Kosovës, me përgjegjësi e thotë që kampe të tilla nuk ka, nëse ka informacione të tilla ftohen që të bashkëpunojnë dhe të shkojnë për ti gjetur ato.

Riza Shillova- Duke u ndërlidhur me çështjen e minimizimit për situatën e sigurisë në Kosovë që u theksua, shtoi që në vazhdimësi bëhet vlerësimi i situatës së sigurisë në Kosovë, dhe kjo bëhet përmes mekanizmave që bëhet edhe nga EUROPOL-i. Theksoi që për këtë vit kanë qenë 709 raste të krimit të rëndë dhe krimit të organizuar, nga këto janë ngritur 566 kallxime penale me kryes të panjohur dhe 41 me kryes të panjohur dhe kjo tregon që mbi nëntëdhjetë përqind shkalla e zbulueshmërisë së rasteve është e aplikueshme. Pasi nuk merret vetëm një rast për të krijuar shkallën e rrezikshmërisë së vendit, ku gjithsej janë arrestuar 902 persona. Po ashtu Policia e Kosovë prinë me konfiskimin e armëve, përkundër që ka shumë pak trafikim me armë dhe që ndërlidhen me çështje të kufirit. Ndërsa sa i përket aspektit ligjor, theksoi që ka vend për përmirësime, siç është Ligji për parandalim të krimit kibernetikë, ligji për infrastrukturën kritike, por edhe në kodin penal për të cilin janë bërë komentet dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë.

Më tutje theksoi që ka një rritje të bashkëpunimit ndërkombëtar në shkëmbimin e informatave inteligjente.

Zafir Berisha- Shtoi që ekspozimi i pamjes së qytetarëve me mjekra është si rezultat i atyre kampeve, duke shtuar që kemi përgjegjësi ti kthejmë Kosovës imazhin evropian. Shfaqja e simptomave të pasigurisë është bërë jo për të shmangur institucionet e sigurisë por mos të vonohemi në ndërmarrjen e masave.

Kryesuesi- Falënderoi Drejtorin e përgjithshëm të Policisë për raportim, duke shtuar që nga ana e Komisionit do të ofrohet mbështetja në shqyrtimin e projektligjeve dhe për kërkesat e bëra do tu bëhet kërkesë kryetarëve të komunave që të ofrojnë mbështetje.

4. Të ndryshme.

Nuk pati çështje për diskutim. Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj